



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 320/2 prot.,

Datë 16.02.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Almeta GMBH” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-560461-01-16-2023, me objekt: “*Blerje makine teknologjike*” me fond limit 13.661.914 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

Ankimues: “Almeta GMBH” SHPK.
Marikaj, Vorë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lushnje
Lagja “ Kongresi “ Lushnje

Në datën 15.02.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 320/2023 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2023/2884 e operatorit ekonomik “Almeta GMBH” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-560461-01-16-2023, me objekt: “*Blerje makine teknologjike*” me fond limit 13.661.914 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.02.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Almeta GMBH” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Almeta GMBH” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr 320 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Operatori ekonomik “ ALMETA GMBH ” shpk ne bilancin e vitit 2020 ka raport negativ midis aktivitet dhe pasivit ,gje e cila bie ne kundërshtim me Dokumentat Standarte te Tenderit, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit,Pika 2.2.2 ku thuhet se : 2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare, 2020, 2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit. Për këtë arsye oferta e Operatorit ekonomik “ ALMETA GMBH ” shpk , refuzohet.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 16.02.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Anëtar
Anila Malaj**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**